

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Paisje laboratorike të nevojshme për testimin e teknikave inovative në Portin e Durrësit (WP3): Trajtimi i ujit (pluhuri dhe vaji) sipas teknikave të reja me burim WP3-TREASURE”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

MALLRA, Kodet CVP: - Pipeta laboratorike dhe aksesore 38437000-7

VLERA E FONDIT LIMIT:

7,857,600 (shtatë milion e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) **Lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “**Autoriteti Portual Durrës**” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas shtojcës 8, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” dhe shtojcës 9 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve të fundit e financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros minimale vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë në një me vlerë jo më pak se 40% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerë jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtëme

a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese certifikatën **ISO 9001:2015** mbi *“Sistemet e menaxhimit të cilësisë”*, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. **Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.**

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”*, neni 77 pika 1 dhe 4 *“Kërkesat për kualifikim”* dhe neni 79 *“Standardet e Sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor”*, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, neni 40, pika 3 dhe 5, ku citohet *“...Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore...”*.

Gjithashtu, ne baze të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. prot. 2502, datë 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 *“Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”*, ku përcaktohet se kjo Çertifikatë duhet të jetë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kërkesa për certifikime sipas standardeve ISO janë në vetvete një garanci me teper për suksesin e projektit, në lidhje me cilësinë e produktit dhe shërbimeve, sigurinë e informacionit gjatë zhvillimit, gjatë instalimit e konfigurimit dhe gjatë mirëmbajtjes, dhe në lidhje me menaxhimin, kuptimin dhe perkthimin e proceseve të biznesit në procese IT.

b) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese certifikatën **ISO 14001-2015** mbi *“Sistemin e menaxhimit mjedisor”*, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. **Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.**

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 77 pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” dhe neni 79 “Standardet e Sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor”, si dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 3 dhe 5, ku citohet “...Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore...”.

Gjithashtu, ne baze të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. prot. 2502, date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kërkesa për certifikime sipas standardeve ISO janë në vetvete një garanci me teper për suksesin e projektit, në lidhje me cilësinë e produktit dhe shërbimeve, siguri e informacionit gjatë zhvillimit, gjatë instalimit e konfigurimit dhe gjatë mirëmbajtjes, dhe në lidhje me menaxhimin, kuptimin dhe përthimin e proceseve të biznesit në procese IT.

ç) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatën **ISO 45001-2018** mbi “Sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë”, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. **Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.**

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 77 pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” dhe si dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 3 dhe 5, ku citohet “...Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore...”.

Gjithashtu, ne baze të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente..

Kërkesa për certifikime sipas standardeve ISO janë në vetvete një garanci me teper për suksesin e projektit, në lidhje me cilësinë e produktit dhe shërbimeve, sigurinë e informacionit gjatë zhvillimit, gjatë instalimit e konfigurimit dhe gjatë mirëmbajtjes, dhe në lidhje me menaxhimin, kuptimin dhe perktimin e proceseve të biznesit në procese IT.

ISO 45001:2018 është standard për *“Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”*, qëllimi i të cilit është të specifikojë *kërkesat për një sistem të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë (OH&S) dhe jep udhëzime për përdorimin e tij, për t'i mundësuar organizatave të ofrojnë vende pune të sigurt dhe të shëndetshme duke parandaluar dëmtimet në lidhje me punën dhe problemet me shëndetin, eliminimin dhe minimizimin e rreziqeve, si dhe duke përmirësuar në mënyrë proaktive performance.*

Në rastin konkret referuar objektit të prokurimit pavaresisht se kemi të bëjmë me furnizim dhe instalim e mirëmbajtje pajisje duke qenë se vendi vendi i instalimit dhe mirëmbajtjes është Autoriteti Portual, si dhe koha e mirëmbajtjes së pajisjeve është e gjatë, për të shmangur problematikat shëndetësore të stafit që do të merret me këtë proces është kërkuar certifikimi me S SH EN ISO 45001:2018 i kompanisë pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt i kësaj procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë sa 20 % e fondit limit dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) inxhinier elektronik/inxhinier informatik/inxhinier telekomunikacionit / inxhinier mekatronike në stafin e vet të certifikuar/ trajnuar për instalim të vërtetuar nëpërmjet diplomës, çertifikatës/çertifikatave të trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”

të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Inxhinjeri i këtij profili nevojitet për të kryer proceset e instalimit dhe mirmbajtjes së mallrave të cilët do kenë të integruara software dhe qarqe elektroniqe për të cilat duhet asistencë e profesionistit të fushës.

2.3.4 Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (*pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohej, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen*). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor **(të markuara sipas artikullit)** të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet duhet të ngarkohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

Argumentimi: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për pajisjen objekt prokurimi bashkë me aksesoret përkatës, në formë tabele, ku të plotësohet: Emri i kompanisë prodhuese, Emërtimi i katalogut të pajisjes / produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerrë nga katalogu i prodhuesit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqes autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (*ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin*), për *System lundruar për monitorim mjedisor me transmetim të dhënash në kohë reale përmes rrjetit celular 4G LTE dhe data logger* nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë pajisjet objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë, ku deklaron se merr përsipër instalimin, vënien në punë dhe testimin e pajisjeve të ofertuara në momentin e dorëzimit të tyre

Argumentimi: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe do të instalohen dhe konfigurohen dhe të mbulohen demtimet brenda perjudhes së garancisë. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 84, pika 7, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 40, pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë, ku të deklarojë se merr përsipër të kryejë trajnimin e stafit nga punonjës të specializuar për përdorimin e pajisjeve objekt prokurimi.

Argumentimi: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe do të instalohen dhe konfigurohen dhe të mbulohen demtimet brenda perjudhes së garancisë. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 84, pika 2, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 40, pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë, ku të deklarojë se garanton riparimin, mirëmbajtjen dhe furnizimin me pjesë për pajisjet e ofertuara për një periudhë të paktën 5 vjeçare.

Argumentimi: Kërkesa për garantimin e riparimit, mirëmbajtjen dhe furnizimin me pjesë për pajisjet e ofertuara për një periudhë të paktën 5 vjeçare dhe për disponimin e servisit për mirëmbajtjen e pajisjeve objekt i këtij prokurimi e produkteve të ofruara shërben për mbarëvajtjen e vendosjes së tyre në proces pune, si dhe në identifikimin e problemeve të mundshme të trashëguara nga prodhuesi ose montuesit të pajisjeve si dhe në asistimin e çdo punonjësi që mund të ketë vështirësi në vënien në punë të pajisjes.

Kjo kërkesë mbështetet në nenin 40, pika 5/c, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përlogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, në përputhje me parashikimet e nenit 4 ,pika38/b dhe nenit 36,te LPP,si dhe nenit 40,pika 1 dhe 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik

KOMISIONI
